



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Raporti i punës

Janar – Qershor 2016

15.07.2016

Përmbajtja

1. Dogana e Kosovës.....	3
<i>Të hyrat</i>	3
<i>Lehtësimit i tregtisë dhe procedurat me ndikim ekonomik</i>	3
<i>Zbatimi i MSA-së dhe implikimet në të hyra</i>	4
<i>Lirimet sipas pakos fiskale</i>	4
<i>Aktet nënligjore të nxjerra nga Dogana</i>	4
<i>Reformat e Zbatuara nga Doganat e Kosovës</i>	5
2. Administrata Tatimore e Kosovës.....	7
<i>Të hyrat</i>	7
<i>Të hyrat sipas llojeve të tatimeve</i>	8
<i>Lehtësirat për Tatimpaguesit</i>	8
<i>Efektet e pakos së re fiskale</i>	9
<i>Bizneset e pajisura me arka fiskale</i>	9
<i>Rimbursimi i kuponave fiskal</i>	10
<i>Zbatimi i Ligjit për Faljen e Borxheve</i>	10
3. Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës.....	10
4. Agjencia Qendrore e Prokurimit.....	11
5. Departamenti i Buxhetit.....	11
<i>Përmbledhje e ndryshimeve buxhetore gjatë gjashtëmujorit të parë 2016</i>	11
<i>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019</i>	11
<i>Vlerësimet e ndikimeve buxhetore të akteve ligjore/nënligjore</i>	12
<i>Rishikimi i Buxhetit</i>	12
6. Departamenti i Thesarit.....	12
7. Departamenti qendror harmonizues dhe departamenti i auditimit të brendshëm.....	13
8. Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat.....	13
9. Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.....	14
<i>Hartimi i Programit për Reforma në Ekonomi 2017</i>	14
<i>Monitorimi i SBA me FMN</i>	14
<i>Marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim financiar, teknik dhe ekonomik</i>	15
10. Departamenti i Tatimit në Pronë.....	15
11. Departamenti për integritet evropiane dhe koordinim të politikave.....	16
12. Departamenti Ligjor.....	16
<i>Projektligjet e miratuara në Qeveri (të sponsoruar nga Ministria e Financave)</i>	16
<i>Aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria</i>	17
<i>Aktet nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave</i>	17
13. Pikat e rendit të ditës të propozuara dhe aprovuara në Qeveri.....	17
14. Divizioni Administrativ i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar.....	18
15. Zhvillime të tjera.....	18
Aneksi 1: Pranimet dhe pagesat për janar - qershor 2016 dhe krahasimet me vitet paraprake.....	19
Aneksi 2: Shpenzimet për janar – qershor 2016.....	20
Aneksi 3: Buxheti dhe pagesat sipas organizatave buxhetore.....	21

1. Dogana e Kosovës

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – qershor 2016, të hyrat e arkëtuara në kufi kanë shënuar një rritje të konsiderueshme duke arritur në vlerë prej 473.5 milionë euro, që paraqet rritje për 71.0 milion euro, apo për 17.6%, më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e importit të mallrave u rrit për 6.7%, përderisa sasia e importuar u rrit për 6.3%, që nënkupton se kërkesa agregate e brendshme ka qenë ndër shtytësit kryesorë të rritjes së të hyrave të arkëtuara në kufi. Në këtë rritje kanë ndikuar edhe reformat dhe masat e ndërmarra nga Dogana e Kosovës për ngushtimin e hendekut tatimor.

Llojet e të hyrave	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016/2015)
	në miliona Euro			
Të hyrat bruto	382.71	402.52	473.48	18%
TVSH	188.64	194.84	232.90	20%
Tarifa doganore në import	56.68	58.84	62.55	6%
Akciza në kufi	128.52	142.32	170.14	20%
Akciza e brendshme	6.22	5.08	5.84	15%
Tjera /1	2.65	1.43	2.05	43%
Kthimet	-1.26	-1.43	-4.30	201%
Kthimi i TVSH	-0.73	-0.44	-0.32	-26%
Kthimet tjera /2	-0.53	-0.99	-3.98	301%
Të hyrat neto	381.45	401.09	469.18	17%

/1 Kategoria tjera perfshin: tatimet e taksat tjera nga dogana, kundervajtje e denime doganore, te hyrat nga shitja e mallrave, banderrolat, kontrolla e jashtme doganore, fast dogana.

/2 Kthimet tjera perfshijne: kthimet e akcizes, taksas doganore ne importe, dhe taksave tjera doganore.

Lehtësimi i tregtisë dhe procedurat me ndikim ekonomik

Me qëllim të lehtësimit të tregtisë dhe shërbimeve më të mira për bizneset, janë thjeshtëzuar procedurat doganore për eksport duke lansuar sistemin e ri të eksportit, i cili mundëson uljen e kohës së eksportit dhe iu bën të mundshme eksportuesve që direkt nga depot e tyre të dërgojnë mallrat tek pranuesi i tyre në shtetet e tjera. Nga muaji maj, është automatizuar ‘Kanalit të verdhë’, ku rreth 80% e dërgesave që kalojnë nëpër këtë kanal i përfundojnë procedurat doganore në më pak se 5 minuta nga momenti i deklarimit të tyre.

Zbatimi i MSA-së dhe implikimet në të hyra

Dogana ka implementuar ndryshimet të cilat i parasheh Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA). Në gjashtëmujorin e parë, në Zyrën për MSA të Doganës janë trajtuar afro 250 kërkesa. Si rezultat, bizneset kanë përfituar 4.95 milion euro lirime me rastin e importit të mallrave nga vendet e BE-së.

Impakti negativ i MSA-së në të hyra doganore (në euro)	
Taksa Doganore	4,452,764
TVSH	502,297
Total	4,955,061

Lirimet sipas pakos fiskale

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, dogana ka trajtuar autorizimet e 352 importueseve për lirim nga pagesa e TVSH-së të importit të lëndës së parë, pajisje të teknologjisë informative dhe makinerive prodhuese. Gjatë kësaj periudhe, janë importuar në 60 milionë euro vlerë e këtyre mallrave, prej të cilave Dogana ka bërë lirimet nga pagesa e TVSH-së në shumë në shumë prej 10.3 milionë euro.

Kodi	Përshkrimi	Vlera e mallrave të importuara (në euro)	TVSH e liruar
LMP	Linjat dhe makineritë e prodhimit për përdorim në procesin e prodhimit	17,275,432	3,090,457
LPP	Lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit	41,120,170	6,977,112
LQP	Lirim qarkullim lirë për prodhim	998,128	197,536
PTI	Pajisjet e teknologjisë së informacionit	680,313	56,274
	Gjithsej	60,074,045	10,321,381

Aktet nënligjore të nxjerra nga Dogana

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Dogana ka rishikuar ose ka future në fuqi udhëzimet e mëposhtme:

- UA nr. 22/2016 për Strukturën Organizative të Doganës së Kosovës;
- UA nr.23/2016 për Procedurën e thjeshtëzuar dhe aneksi III-Lista e mallrave të lejuara në procedurën e thjeshtëzuar;
- UA nr.24/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 92/2011 që përcakton vendet ku do vendosen zyrat doganore, orari i punës, rrugët dhe afati kohor për paraqitjen e mallrave të sjella në Kosovë.;

- UA nr.25/2016 për marrjen e mostrave, dokumentacionit të mallit dhe trajtimin e tyre në procedurën doganore;
- UA nr.26/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 92/2011;
- UA nr.27/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e UA 22/2016 për Strukturën Organizative të DK-së si dhe shtojca 1;
- UA nr.28/2016 për plotësimin dhe ndryshimin e UA 92/2011 që përcakton vendet ku vendosen zyrat doganore, orari i punës rrugët dhe afati kohor për paraqitjen e mallrave të sjella në Kosovë;
- UA nr.29/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 01 /2014 për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të doganës;
- UA nr.30/2016 për Dosjet dhe Regjistrin e Oficerëve Doganor.

Reformat e Zbatuara nga Doganat e Kosovës

Dogana ka bërë funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të procedurave doganore përmes ASYCUDA World dhe përzgjedhja e kontrolleve bazuar në rrezik. Është zgjeruar korridori i gjelbër për dërgesat me rrezik të ulët si dhe është hapur korridori i kaltër për ofrimin e procedurave të thjeshtëzuara të zhdoganimit pas lirim të dërgesës. Nga muaji Maj 2016, janë thjeshtëzuar procedurat e dërgesave që konsiderohen se bartin rrezik mesatar të shmangies. Si rezultat i këtyre reformave: (i) është shkurtuar koha e nevojshme për kryerjen e procedurave kufitare, (ii) vetëm 7% e dërgesave për eksport i nënshtrohen kontrollit, (iii) më pak se 10% e dërgesave të importit i nënshtrohen kontrollit fizik, dhe (iv) është ulur frekuenca e kontrolleve dokumentare.

Është funksionalizuar korridori i përbashkët transit me Republikën e Shqipërisë. Si rezultat, është eliminuar nevoja për procedura transiti në pikën kufitare Morinë; tani transiti hapet në terminalin doganor në Kosovë dhe përmbyllet në portin e Durrësit, duke gjeneruar kështu kursime të mëdha në kohë dhe kosto.

Projekti ‘Paperless-Pa letër’ ka filluar implementimin nga korriku 2015. Ky është një koncept bashkëkohor i cili buron nga direktiva e BE-së No 70/2008/EC për eliminimin e procedurave dhe barrierave burokratike e administrative. Kjo ka eliminuar kërkesën për prezantimin e dokumenteve fizike në Doganë. Është shkurtuar koha e nevojshme për pajtueshmëri dokumentare në eksport dhe import për më shumë se 2 orë.

Nga Shtatori 2015, Doganat e Kosovës ka filluar pranimin e pagesave elektronike (E-payments). Kjo ka përshpejtuar procedurat e zhdoganimit të mallrave.

Është duke u bërë këmbimi i informatave me partnerët fqinj përmes sistemit SEED. Dogana këmben informatat e nevojshme për zhdoganim para arritjes së dërgesave të importit. Kjo ka shkurtuar kohën për përmbushjen e procedurave të zhdoganimit.

Me kërkesë të komunitetit të biznesit, janë operacionalizuar Terminalët e Brendshme Doganore, të cilat u mundësojnë tregtarëve që, sipas përzgjedhjes së tyre, procedurat e zhdoganimit t'i përfundojnë brenda terminaleve doganore që janë më afër depove apo selive të tyre. Kjo masë ka ndikuar në shkurtim të rëndësishëm të kohës dhe kostos së transportit dhe pajtueshmërisë kufitare.

Është intensifikuar bashkëpunimi me partnerët tregtar për të lehtësuar tregtimin, duke përfshirë edhe njohjen e përbashkët të lejeve, licencave, dhe kërkesave tjera të konformitetit. Për shembull, janë ndërmarrë hapa konkret në operacionalizimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë me Republikën e Shqipërisë. Kosova veç se ka filluar iniciativën e ngritjes së bashkëpunimit në mes shteteve të rajonit për njohjen reciproke të dokumenteve të konformitetit.

2. Administrata Tatimore e Kosovës

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – qershor 2016, të hyrat e arkëtuara vendore kanë shënuar 177.3 milionë euro, që paraqet rritje për 14.8 milion euro, apo për 9.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa krahasuar me planin për vitin 2016 kemi realizim prej 96.1%. Gjatë periudhës raportuese, vlera e arkëtuara nga të hyrave rregullta vendore arritën në 169.6 milionë euro dhe të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor në shumën 7.8 milionë euro.

Llojet e të hyrave	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016/2015)
	në miliona Euro			
Të hyrat bruto	148.08	162.54	177.33	9%
TVSH /1	64.94	71.09	74.09	4%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	29.82	35.80	44.06	23%
Tatimi në të ardhurat personale	52.40	54.78	58.39	7%
Të hyrat nga gjokat e ATK-së	0.88	0.83	0.78	-7%
Të hyrat tjera të grumbulluara nga ATK /2	0.03	0.03	0.02	-54%
Kthimet	-15.59	-13.72	-15.16	10.5%
Kthimi i TVSH - së	-15.40	-12.55	-14.83	18%
Kthimet tjera /3	-0.19	-1.17	-0.33	-72%
Të hyrat neto	132.49	148.82	162.17	9%

/1 Përfshin edhe të hyrat nga TVSH e shtyrë.

/2 Kjo kategori përfshin: mbledhjet e borxheve nga tatimi i paragjykuar dhe tatimi në fitim, licencat për lojra, të hyrat nga shitja e mbeturinave, konton kaluese, kompenzimet e dëmeve nga kompanitë e sigurimeve, të hyrat nga shitja e mallrave të konfiskuara, dhe tatimin mbi qira nga pasuria e patrupëzuar.

/3 Kjo kategori përfshin kthimet për tatimet tjera përveç TVSH-së

Tatimi në Vlerën e Shtuar ka shënuar një ngritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 4.2%. Vlerësohet se ky trend të inkasimeve nga TVSH-ja gjatë këtij gjashtëmujori është i përkohshëm, dhe pritet që gjatë muajve në vijim të kemi një zhvendosje mes arkëtimin të TVSH-së në brendi dhe në kufi.

Kjo zhvendosje e arkëtimin në brendi ndikohet edhe nga politikave të reja pas vendosjes së lirimeve nga pagesa e TVSH së me rastin e importit pajisjeve dhe te lendeve te para për mallra të caktuara, të cilat në fazë e mëvonshëm do te reflektohen si pagesa në brendi me rastin e shitjes së produkteve apo shërbimeve nga subjektet përfituese.

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave kanë shënuar rritje prej 23% krahasuar vitin paraprak, ku vlerësohet të ketë ndikuar profiti i bankave komerciale, ndërkaq ka një ngritje prej 7% tek tatimi në të ardhurat personale (këtu përfshihet tatimi i mbajtur në burim dhe tatimi në të ardhurat nga biznese individuale).

Gjatë kësaj periudhe, si rezultat i aktiviteteve për implemtimin e Ligjit 05/L-043, nga ATK-ja janë inkasuar 7.8 milionë euro, prej të cilave nga arkëtimi i borxhit tatimor 5.1 milionë euro dhe nga borxhet e Ndërmarrjeve Shoqërore ndaj ATK-së 2.7 milionë euro.

Të hyrat sipas llojeve të tatimeve

Në strukturën e të hyrave sipas llojeve të tatimeve, pjesëmarrje më të madhe ka TVSh-ja me 42.0%, Tatimi në Korporata me 25.0%, Tatimin e mbajtur në Burim me 21.9%, Tatimi për Bizneset Individuale me 9.5%, dhe në Tatimi në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit 1.6%.

Lloji i tatimit	Të hyrat sipas viteve			%	Plani 2016	Krahasimi	
	2014	2015	2016			7=4/6	8=4/3
1	2	3	4	5=4/Σ	6	7=4/6	8=4/3
TVSH	65,747,050	71,492,046	74,420,312	42.0%	81,342,338	91.5%	104.1%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	30,135,216	35,999,257	44,252,703	25.0%	38,697,125	114.4%	122.9%
Tatimi në të ardhurat personale	32,624,446	34,935,215	38,856,863	21.9%	38,492,890	100.9%	111.2%
Tatimi për biznese individuale	17,156,532	15,587,219	16,876,812	9.5%	19,982,339	84.5%	108.3%
Interes, qira, drejta pronësore	3,328,519	4,564,922	2,920,586	1.6%	7,459,108	39.2%	64.0%
Gjithsej	148,991,762	162,578,659	177,327,275	100.0%	185,973,800	95.4%	109.1%

Lehtësirat për Tatimpaguesit

Gjatë kësaj periudhe, ATK ka thelluar reformat si në vijim:

- Deklarimi elektronik – EDI: janë regjistruar 59,032 tatimpagues. Deri më tani këtë system e shfrytëzojnë 52,199 tatimpagues. Janë dorëzuar 203,258 deklarata bazuar në këtë system.
- Vërtetimi Tatimor Elektronik: janë lëshuar 33,492 vërtetime.

- Qendra e Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve: janë kthyer përgjigje në 1,680 raste. Kjo qendër frekuentohet mesatarisht nga 500 tatimpagues gjatë ditës. Janë mbajtur 16 seminare me tatimpagues.
- Qendrat One Stop Shop: Janë regjistruar 38,793 biznese të reja për të marrë shërbime nga kjo qendër

Efektet e pakos së re fiskale

Si rezultat i zbatimit të pakos fiskale, ATK ka lëshuar 335 autorizime për lirim nga TVSH të importit të lëndës së parë, pajisje të teknologjisë informative dhe makinerive prodhuese. Është duke u zbatuar plotësisht ulja e pragut të TVSH-së nga 50 mijë në 30 mijë euro dhe përshtetja e TVSH-së në 8% dhe 18%. Po aplikohen procedurat e përshtetura të rimbursimit bazuar në reformën fiskale, si dhe zbritjet në të ardhurat e liruara për kontributet bamirëse (10+10)%.

Bizneset e pajisura me arka fiskale

Deri më tani janë gjithsej 23,786 biznese të pajisura me arka fiskale, ndërsa gjatë periudhës janar-qershor 2016 janë fiskalizuar 1,358 biznese.

Më së shumti biznese të pajisura me arka fiskale kemi në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë me gjithsej 12,757 biznese, pastaj 2,922 biznese janë në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor, 2,613 biznese janë në sektorin e industrisë përpunuese, 1,467 biznese janë në sektorin e aktiviteteve tjera shërbyese, 1,259 biznese janë në sektorin e aktiviteteve të shëndetit të njeriut.

Më poshtë gjenden informacionet lidhur me numrin e bizneseve që janë fiskalizuar për gjashtë muajt e parë të vitit 2015 dhe 2016, si dhe krahasimin e tyre.

Përshkrimi	Janar-Qershor 2015	Janar-Qershor 2016	Krahasimi 2016/2015
Numri i bizneseve të reja të fiskalizuara	1057	1358	28.48%
Numri i pajisjeve elektronike fiskale të instaluar	1577	1961	24.35%

Rimbursimi i kuponave fiskal

Po vazhdon projekti i rimbursimit të qytetarëve nga mbledhja dhe dorëzimi i kuponëve fiskal. Gjatë periudhës janar-qershor 2016 janë verifikuar 136,791 pliko kuponë fiskal, ku vlera e rimbursimit të tyre është 2,485,280 euro.

Periudha	Numri i plikove të dorëzuara	Numri i plikove të verifikuar	Numri i plikove të rimbursuara	Shuma e rimbursimit
TM2/2015	24,263	22,428	22,220	341,865 €
TM3/2015	56,219	54,445	54,035	910,635 €
TM4/2015	127,376	124,680	123,393	2,209,605 €
TM1/2016	171,436	167,390	165,425	2,993,825 €
TM2/2016*	215,342	47,817	17,431	334,920 €
Totali	594,636	416,760	382,504	6,790,850 €

* Kjo periudhë është ende në fazën e pranimit dhe verifikimit të plikove.

Refuzimi i rimbursimeve bëhet për arsye të gabimeve në informacionet si numri personal, emri/mbiemri, numri i llogarisë bankare etj.

Pranimi i plikove përmes postës ka ulur vonesat për qytetarë. Komunikimi me zyrtarët e postës është mjaft efikas. Qytetarët aplikojnë online për dorëzimin e kuponëve në faqen e ATK-së dhe i dorëzojnë plikot në postë. Verifikimi i plikove mbetet sfida kryesore e zyrtarëve të ATK-së.

Zbatimi i Ligjit për Faljen e Borxheve

Vlera e borxhit që është falur gjatë kësaj periudhe është mbi 51.4 milion euro, ndërsa vlera e pagesave të realizuara si pasojë e zbatimit të Ligjit për faljen e borxheve publike është mbi 5.5 milion euro.

3. Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës

Gjatë kësaj periudhe, NJIF ka përbushur pothuajse të gjitha aktivitetet e parapara me plan, prej të cilave një aktivitet ka të bëjë me masat legislative si dhe nëntë aktivitete lidhen me masat zbatuese. Gjatë kësaj periudhe është miratuar dhe ka hyrë në fuqi e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit. Po punohet në fuqizimin e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit përmes adaptimit të sanksioneve ndërkombëtare.

4. Agjencia Qendrore e Prokurimit

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) gjatë periudhës janar-qershor 2016, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, ka zhvilluar 8 aktivitete të prokurimit, prej tyre janë nënshkruar pesë kontrata me vlerë 35.9 milion euro, një kontratë është në fazën e ri-vlerësimit si dhe dy kontrata janë në shqyrtim në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Po ashtu, AQP ka zhvilluar edhe tre aktivitete të prokurimeve të veçanta me vlerë prej 27 mijë euro.

5. Departamenti i Buxhetit

Përmbledhje e ndryshimeve buxhetore gjatë gjashtëmuajorit të parë 2016

Gjashtëmuajori i parë i vitit 2016 është karakterizuar me një ritëm të përshpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015, ku rol të veçantë kanë luajtur masat e ndërmarra në kuadër të reformave të të bërit biznes, rritja e besueshmërisë së investitorëve, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm dhe gradual i ambientit të jashtëm ekonomik në përgjithësi. Përveç ndikimit të këtyre politikave, në trendin pozitiv të të hyrave kanë ndikuar edhe masat e ndërmarra nga agjencitë mbledhëse të të hyrave për ngushtimin e hendekut tatimor dhe rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të hyrave tatimore.

Të hyrat kanë shënuar rritje prej 17.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kryesisht nga të hyrat e rregullta tatimore.

Shpenzimet gjithsej kanë shënuar rritje prej 10.0%, ku kontributin më të madh në këtë rritje e ka dhënë rritja e shpenzimeve kapitale, si dhe rritja e shpenzimeve në subvencione dhe transfere. Nga këto shpenzime, 38.0% janë paga dhe mëditje, 29.6% janë subvencione dhe transfere, 18.2% janë shpenzime kapitale, 12.2% janë mallra dhe shërbime, dhe 1.4% pagesa e interesit për borxhin shtetëror.

Gjendja e fondeve me 30 qershor 2016 është 346.45 milionë Euro. Gjendja fillestare e fondeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës në vitin 2016 ka qenë 256.54 milionë Euro, si rezultat i të hyrave të grumbulluara më të mëdha se sa shpenzimet për periudhën Janar – 30 Qershor 2016 kemi rritje të fondeve për 87.22 milionë euro.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019

Hartimit të kësaj kornize i ka paraprirë një proces i gjatë konsultativ me të gjitha organizatat buxhetore, në harmoni me dokumentet strategjike të Qeverisë. Projektionet makroekonomike

për KASH 2017-2019 janë përgatitur duke marrë për bazë të gjitha politikat të cilat janë duke u implementuar si dhe iniciativat e reja, të inkorporuara edhe në kornizën makro-fiskale.

Zhvillimet e fundit ekonomike të shoqëruara me implementimin e politikave të orientuara drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe reformave strukturore japin indikacione për një rritje relativisht të lartë ekonomike përgjatë kësaj periudhe, e cila parashihet të arrijë në një mesatare prej 4%.

Projeksionet e të hyrave buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesor makroekonomik, përfshirë këtu lëvizjen e importit, çmimeve si dhe vlerësimet mbi rritjen e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave.

Vlerësimet e ndikimeve buxhetore të akteve ligjore/nënligjore

Në bazë të kërkesave të institucioneve të ndryshme, Departamenti i Buxhetit ka përgatitur 76 opinione të ndikimit buxhetore për: 27 projektligje, 8 projekt-rregullore, 5 udhëzime administrative, 5 strategji, 25 koncept dokumente, 1 plan veprimi, 1 program, 1 marrëveshje për kredi dhe 3 plane strategjike.

Rishikimi i Buxhetit

Është përgatitur rishikimi i buxhetit për 2016. Ndryshimet kryesore përfshijnë: të hyrat e përgjithshme buxhetore janë vendosur në 1.635 miliardë euro, ndërkaq shpenzimet rrjedhëse 1.223 miliardë euro. Janë rritur kufijtë e të hyrave për 33 milion euro dhe janë identifikuar kursime 5 milion euro në mallra dhe shërbime.

6. Departamenti i Thesarit

Departamenti i Thesarit ka punuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të letrave me vlerë. Janë lëshuar letra me vlerë me afat më të gjatë të maturimit, duke e rritur kohëzgjatjen mesatare të maturitetit të letrave me vlerë. Janë bërë të gjitha përgatitjet për lansimin e produktit të ri të letrave me vlerë që janë bonot e thesarit për diasporë. Është ngritur sistemi SIMFK në standardin ISO 20022 dhe janë ngritur kapacitete e stafit për përdorim të këtij sistemi. Është bërë progres në ndërlidhjen e komunave veriore në sistemin SIMFK të thesarit.

Është menaxhuar borxhi i përgjithshëm i Kosovës, i cili ka arritur në 804 milion euro, që është rreth 13% e Bruto Prodhimit Vendor që ka Kosova. Kjo vlerë është shumë e ulët krahasuar me vendet në rajon, të cilat kanë borxh prej 40% deri në 76% të BPV-së së tyre.

Është paguar rregullisht pa asnjë vonesë borxhin publik. Është përmirësuar struktura dhe karakteristikat e borxhit publik të Kosovës, ku: (i) rreth gjysma e borxhit është borxh i brendshëm, tek bankat dhe subjektet vendore, që është krijuar përmes lëshimit të letrave me vlerë; (ii) me kalimin e kohës, letrat me vlerë janë me afat gjithnjë e më të gjatë dhe kjo e përmirëson stabilitetin buxhetor; (iii) norma e baraspeshuar e interesit për borxhin publik është vetëm 2.5%; (iv) rreth 82% e borxhit ka normë fikse të interesit. Si rezultat, Kosova është në pozitë të volitshme sa i përket borxhit publik, prandaj ka hapësirë të mjaftueshme për të marrë kredi zhvillimore.

7. Departamenti qendror harmonizues dhe departamenti i auditimit të brendshëm

Në këtë gjashtëmuor, DQH ka përgatitur raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike për vitin 2015. Pjesë e këtij raporti është menaxhimi financiar dhe kontrollit dhe auditimi i brendshëm. Raport është përgatitur në bazë të pyetësorëve vet vlerësues të cilët janë shpërndarë tek të gjitha organizatat buxhetore.

Po ashtu janë mbajtur edhe organizuar edhe trajnime për 107 zyrtarë financiar lidhur me planifikimin strategjik në kontekst të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Lidhur me aftësimin e zyrtarëve, me kërkesë të Ministrisë janë përgatitur manuali dhe modulet për trajnimin e auditorëve të brendshëm në programin për certifikim, program i ky i cili përherë të parë ka aplikuar për akreditim në Autoritetin Kombëtar Kualifikues.

Sa i për ketë Auditimit të Brendshëm, gjatë këtij gjashtëmuor janë kryer finalizuar 8 raporte të auditimeve, me 98 të gjetura dhe 26 rekomandime.

8. Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat

Departamenti Qendror Publiko Privat ka qenë i angazhuar në promovimin e partneritetit publiko privat në nivel lokal dhe qendror. Ndër aktivitete më të rëndësishme janë organizimi i trajnimeve për ngritje të kapaciteteve në fushën e partneritetit publiko privat si dhe bashkëpunimi dhe ofrimi i këshillave në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe në përputhje me Ligjin e PPP.

Gjatë këtij gjashtëmuor janë mbajtur takime dhe është ofruar asistencë për:

- Komunën e Mitrovicës në lidhje me projektin e Mbikalimit dhe 2 projekte të tjera komunale,

- Komunën e Prizrenit në lidhje me projektin e Tregjeve të Prizrenit, Varrezave të reja,
- Komunën e Prishtinës në lidhje me 4 projekte potenciale si dhe freskimin e dokumentacionit për projektin e parkingut nëntokësor prapa Hotel Grand,
- Komunën e Gjakovës në lidhje me 2 projekte komunale,
- Komunën e Ferizajt në lidhje me 6 projekte potenciale PPP,
- Komunën e Pejës në lidhje me 4 projekte komunale për PPP, përfshirë edhe projektin BOREA.

Departamenti ka përgatitur 4 takime të Komitetit për Partneritet Publiko-Privat, ku janë shqyrtuar projektet e komunave dhe disa projekte të dorëzuara në Departament.

9. Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Hartimi i Programit për Reforma në Ekonomi 2017

Programi i Reformave në Ekonomi 2017 është dokument që Kosova dorëzon tek Komisioni Evropian si pjesëmarrës i rregullt në procesin e para-anëtarësimit si rrjedhojë e dialogut mes BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të së ashtuquajturës ‘qeverisje ekonomike’. Ky dokument paraqet një instrument planifikimi të reformave përmes të cilave Qeveria planifikon të shtyjë zhvillimin ekonomik të vendit përgjatë periudhës 2017-2019. Ky dokument trajton tema jashtëzakonisht të rëndësishme për shtetin tonë, si: Menaxhimi i Financave Publike, Tregu i Energjisë, Transportit dhe Telekomunikacionit, Zhvillimet sektoriale, Mjedisin Biznesor dhe zvogëlimi i ekonomisë joformale, Hulumtim dhe Inovacion, Tregtia e jashtme dhe lehtësimin e investimeve, Arsimit dhe Shkathtësitë, Punësimi dhe Tregu i punës, Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta. Komisioni Evropian ka dhënë vlerësime shumë të larta për këtë dokument.

Monitorimi i SBA me FMN

Njësia e Makroekonomisë ishte e përfshirë intensivisht në përgatitjet për misionin e FMN-së (23 mars – 5 prill 2016), ku raportohet mbi ecurinë e programit Stand-By me këtë institucion, si dhe diskutohen gjerësisht zhvillimet makro-fiskale.

Marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim financiar, teknik dhe ekonomik

Janë nënshkruar 2 marrëveshje për bashkëpunim financiar në vlerë totale prej 5 milion euro, prej të cilave 2.5 milion janë kredi dhe 2.5 milion euro grante. Marrëveshjet të cilat vlen të theksohen janë: (i) Marrëveshja me KfW-në për Eficiencë në Energji në ndërtesat publike për nivelin Komunal; dhe (ii) Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me anë të së cilës mundësohet marrja e kredisë për Trafikun Urban për blerjen e 51 autobusëve (garancion).

Gjatë kësaj periudhe Ministria e Financave po vazhdon negociatat për eliminimin e tatimit të dyfishtë me vendet ku kemi diasporë të madhe, me Austrinë dhe Zvicrën dhe nënshkrimi i tyre do të behet në vjeshtë. Është nënshkruar edhe Marrëveshjen për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me Emiratet e Bashkuara Arabe.

Ministria e Financave ka arritur gjatë këtij viti të marrë përsipër negocimin e Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim ekonomik me Qeverinë Gjermane. Kjo marrëveshje zëvendëson marrëveshjet e ish-Jugosllavisë dhe vendos bazë të re më të afërt të bashkëpunimit teknik dhe financiar të Kosovës me Gjermaninë. Kjo Marrëveshje do të negociohet dhe nënshkruhet në vjeshtë të këtij viti.

10. Departamenti i Tatimit në Pronë

Departamenti i Tatimit në Pronë ka lëshuar 510,281 fatura të tatimit në pronë nëpër komuna, të cilat kapin vlerën prej 25,534,237.05 Euro, prej të cilave janë inkasuar në total 10,806,655.40 euro. Nga kjo shumë, për vitin aktual janë inkasuar 6,317,930.77 euro, ndërkaq shuma prej 4,488,724.63 është inkasuar nga kryegjëja, interesat dhe dënimet për vitet paraprake. Gjatë periudhës janar-qershor 2016, të hyrat e tatimit në pronë u rritën për 1,010,798.76 euro apo 16% krahasuar me vitin paraprak. Pothuajse të gjitha komunat kanë pasur rritje të inkasimit të tatimit në pronë, me përjashtim të këtyre komunave: Drenas, Shtime, Graçanicë, Prizren, Mamushë, Deçan dhe Junik.

Është kryer inspektimi vjetor në 19 komuna dhe janë trajnuar 68 zyrtarë komunalë në 22 komuna. Është avancuar sistemi i vlerësimit të tatimit në pronë. Është lëshuar në përdorim e-fatura për tatimin në pronë, ku qytetarët mund të kyçen, të shtypin dhe të paguajnë faturën e tatimit në pronë. Janë kryer proceduar e vlerësimit të shpronësimit për 29 kërkesa të komunave dhe 16 kërkesa të nivelit qendror.

11. Departamenti për integritet evropian dhe koordinim të politikave

Është përgatitur analiza për implikimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit (MSA) për Ministrinë e Financave. Është hartuar Raporti për zbatimin e konkluzioneve të dala nga takimi i Grupit të Veçantë për Reformë në Administratën Publike. Në fillim të prillit kanë filluar përgatitjet për takimin e Dialogut të Procesit të Stabilizimit Asociimit për “Ekonomi, Statistika dhe Kontroll Financiar” me Komisionin Evropian i cili u mbajt në Prishtinë me datë 31 maj 2016. Lidhur me Objektivin Koordinimi sa më i mirë i Asistencës së Jashtme në kuadër të MF-së, gjatë periudhës raportuese është dhënë kontribut në adresimin e nevojave të ATK në fushën e TI.

12. Departamenti Ligjor

Nga gjithsej 22 projektligje në Programin Legjislativ për 2016 nga Ministria e Financave, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 9 projektligje nga Qeveria e Kosovës. Në këtë periudhë raportuese, Ministria e Financave ka realizuar 40 % të Programit të saj Legjislativ.

Sa i përket akteve nënligjore, janë përgatitur 6 Udhëzime Administrative dhe 3 Rregullore:

- 2 Udhëzime Administrative si dhe 2 Rregullore të sponsoruara nga Ministria e Financave janë miratuar në Qeveri,
- 4 Udhëzime Administrative janë miratuar nga Ministri,
- 1 Rregullore është miratuar nga Ministri.

Projektligjet e miratuara në Qeveri (të sponsoruar nga Ministria e Financave):

1. Projektligji për plotësim/ndryshimin e Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/l-068;
2. Projektligji Nr. 05/l-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
3. Projektligji për Ndihmën Shtetërore;
4. Projektligji për plotësim/ndryshimin e Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;
5. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiokirurgjisë invazive në QKUK;
6. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt Am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Nivelin Komunal në Kosovë”;

7. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Rehabilitimin e Rrugëve Rajonale;
8. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikë së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10;
9. Projektligji për plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria:

1. Rregullore (QRK) nr.06/2016 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës së përdorimit/shfrytëzimit të mallrave të konfiskuara nga Dogana,
2. Rregullore (QRK) nr.09/2016 për shitjen e pakicë të obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
3. UA (QRK) nr.05/2016 për zbatimin e procedurave të prokurimit publik,
4. UA (QRK) nr.07/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e UA (QRK) nr.05/2015 për mallrat e liruar nga tatimi doganor.

Aktet nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave:

1. UA (MF) nr.01/2016 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale
2. UA (MF) nr.02/2016 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave,
3. UA (MF) nr.03/2016 për plotësimin-ndryshimin e UA nr.15/2010, i ndryshuar dhe plotësuar me UA nr.01/2012, UA nr.03/2015 dhe UA nr.01/2016 - për vizitat edukative për tatimpagues, regjistrim të tatimpaguesve në TVSH dhe regjistrimin e të punësuarve,
4. UA (MF) nr.04/2016 për programin kombëtar të trajnimit dhe certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik,
5. Rregullore (MF) nr.01/2016 për administrimin e fondeve nga huamarrja.

13.Pikat e rendit të ditës të propozuara dhe aprovuara në Qeveri

Nga 24 mbledhja sa ka mbajtur Qeveria gjatë periudhës janar-qershor 2016, ka trajtuar 279 pika të rendit të ditës. Prej tyre, 60 pika kanë qenë të përgatitura nga Ministria e Financave. Si përqindje, rezulton se 21.5% e pikave të rendit të ditës të Mbledhjeve të Qeverisë i ka përgatitur Ministria e Financave.

14.Divizioni Administrativ i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar

Gjatë periudhës gjashtë mujore, në bashkëpunim me ATK-në, KKRF-ja organizuar seminare në 7 regjione të Kosovës me temë: Raportimi i Pasqyrave Financiare sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim Nr. 04/L-014. Grupi punues i emëruar nga MF me vendimin Nr. 09-2015 për Hartimin e draftit fillestar të projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim ka përfunduar draft plotësimin e ligjit i cili së shpejti do të përcjellët në Qeveri për miratim.

15.Zhvillime të tjera

Po ashtu gjatë kësaj periudhe Ministria e Financave ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës për praktikë të 600 studentëve në vit. Praktikë kjo të cilën do ta kryejnë në Ministri dhe në Agjencitë e saj.

Aneksi 1: Pranimet dhe pagesat për janar - qershor 2016 dhe krahasimet me vitet paraprake

Përshkrimi	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016/2015)
	në miliona Euro			
1. GJITHSEJ PRANIMET	693.89	722.53	841.78	17%
1.1 Të hyrat buxhetore	602.70	646.09	736.72	14%
1.1.1 Të hyrat tatimore	523.79	559.42	642.50	15%
1.1.1.1 Tatimet Direkte	94.87	102.29	116.36	14%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	29.82	35.80	44.06	23%
Tatimi në të ardhurat personale	52.40	54.78	58.39	7%
Tatimi në pronë	9.85	9.52	11.05	16%
Tatime tjera direkte	2.80	2.19	2.86	30%
1.1.1.2 Tatimet Indirekte	445.77	472.28	545.61	16%
Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH	253.58	265.94	306.98	15%
Detyrimi Doganor	56.68	58.84	62.55	6%
Akcizat	134.74	147.40	175.98	19%
Tatimet tjera indirekte	0.76	0.10	0.09	-10%
1.1.1.3 Kthimet Tatimore	(16.85)	(15.15)	(19.46)	28%
1.1.2 Të hyrat jo-tatimore	78.91	86.67	94.21	9%
Taksa ,ngarkesa dhe tjera nga OB-të e Qeverisë	47.66	43.94	57.44	31%
Qendrore				
Taksa ,ngarkesa dhe tjera nga OB-të e Qeverisë Lokale	15.91	15.81	18.96	20%
Taksa koncesionare	1.00	2.92	3.20	10%
Tantiemat	14.33	14.00	14.61	4%
Të hyrat nga Dividentat	-	10.00	-	-100%
1.2 Pranimet nga financimi	91.20	76.44	105.06	37%
Huamarrja	85.95	65.86	101.72	54%
Huamarrja e brendshme	82.99	62.03	60.56	-2%
Huamarrja e jashtme	2.96	3.83	41.16	976%
Të hyrat e dedikuara nga AKP	-	5.50	-	0%
Pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve	4.71	4.65	3.34	-28%
Pranimet nga depozitat në mirëbesim	0.54	0.43	-	0%
2. GJITHSEJ PAGESAT	651.12	686.25	754.56	10.0%
2.1 Shpenzimet buxhetore	630.87	667.20	716.37	7%
2.1.1 Shpenzimet rrjedhëse	487.88	544.39	572.02	5%
Paga dhe rroga	232.62	258.50	272.42	5%
Mallra dhe shërbime	79.69	76.98	75.12	-2%
Shpenzime komunale	11.22	12.52	12.58	1%
Subvencione dhe transfere	164.35	196.39	211.90	8%
Transfere sociale	123.69	146.76	169.05	15%
Subvencione (ndërmarrje publike , bujqësi , etj.)	40.66	49.64	42.85	-14%
2.1.2 Shpenzimet kapitale	136.66	115.60	134.24	16%
2.1.3 Shpenzimet e interesit për borxhin shtetëror	6.33	7.22	10.11	40%
2.2 Pagesat për financim të borxhit dhe grantet	20.25	19.05	38.19	100%
Kthimi i kryegjesë së borxhit	10.95	11.50	32.55	183%
Pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve	8.43	6.65	5.64	-15%
Pagesat nga depozitat në mirëbesim	0.88	0.90	-	0%
3. BILANCI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE (1.1-2.1)	(28.17)	(21.08)	20.34	-197%
4. RRIJTJA/ZVOGËLIMI I PARASË SË GATSHME (1-2)	42.77	36.28	87.22	140%
5. BILANCI I FONDEVE - Gjendja e parasë së gatshme (4+5.1+5.2)	253.06	202.86	346.45	71%
5.1 Konto kaluese-Diferencë kohore SIMFK-BQK	(1.49)	3.08	2.70	
5.2 Gjendja e parasë së gatshme në fillim të vitit	211.78	163.50	256.54	
4.3 Gjendja e parasë së gatshme në fund të periudhës	253.06	202.86	346.45	71%

Ankesi 2: Shpenzimet për janar – qershor 2016

Llojet e shpenzimeve	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016/2015)
1. Shpenzimet rrjedhëse	487.88	544.33	572.02	5%
1.1 Paga dhe rroga	232.62	258.46	272.42	5%
Pagat	199.11	219.70	231.22	5%
Tatimi në të ardhurat personale	11.37	13.43	14.58	9%
Kontributi pensional i punëtorit	11.06	12.27	12.89	5%
Kontributi pensional i punëdhënësit	11.08	12.28	12.90	5%
Pagesat për sindikatë	-	0.77	0.83	8%
Meditjet	-	-	-	-
Pagesa për vendime gjyqësore	-	-	-	-
1.2 Mallra dhe shërbime	79.69	76.97	75.12	-2%
Shpenzimet e udhëtimit	4.93	4.34	4.82	11%
Shpenzimet e telekomunikimit (mobil, internet, postar)	2.03	2.01	2.20	10%
Derivatet, lëndet djegëse	10.06	9.26	7.94	-14%
Shpenzimet për Shërbime	20.55	18.68	17.93	-4%
Mirëmbajtja (e objekteve, rrugëve, automjeteve, etj.)	11.20	11.15	12.37	11%
Qiraja (për objekte publike)	3.48	3.43	3.47	1%
Blerja e mobiljeve dhe paisjeve më pak se Eur. 1000	1.92	1.72	1.54	-10%
Blerje tjera për mallra & shërbime	24.14	25.09	23.26	-7%
Llogaritë e avansit	0.37	0.30	0.31	3%
Tatimi në qira	0.03	0.03	0.04	20%
Servisimi i borxhit	-	-	0.10	-
Shpenzimet për vendime gjyqësore dhe Nenin 39.2 LMFPP	0.97	0.95	1.12	18%
1.3 Shpenzimet komunale	11.22	12.51	12.58	0.6%
Rryma	7.57	8.21	7.61	-7%
Uji	1.39	1.48	1.62	10%
Mbeturinat	0.73	0.72	0.74	2%
Ngruhja qendrore	0.62	1.43	1.61	13%
Shpenzimet telefonike (fikse)	0.90	0.62	0.87	41%
Shpenzimet për vendime gjyqësore dhe Nenin 39.2 LMFPP	0.02	0.05	0.13	178%
1.4 Subvencionet dhe Transferet	164.35	196.39	211.90	8%
1.4.1 Transferet sociale	123.69	146.76	169.05	15%
Pensionet	91.03	109.82	113.51	3%
Pensionet bazë	78.63	59.06	60.02	2%
Pensionet bazë të kontributdhënësve /1	-	33.47	36.19	8%
Pensionet për personat me nevoja të veçanta	9.36	10.52	10.88	3%
Pensionet për të verberit	-	3.15	2.57	-18%
Pensionet e përkohshme të Trepçës	1.82	2.13	2.23	5%
Pensionet e FSK-së	-	0.27	0.36	32%
Pensionet e TMK-së	1.22	1.21	1.25	3%
Pagesat për kategoritë e luftës	17.05	18.89	18.69	-1%
Pagesat për veteranet e luftës	-	-	20.24	-
Pagesat për të burgosurit politik	0.75	6.58	2.89	-56%
Ndihmat sociale /2	11.28	9.96	11.92	20%
Pushimi i lehonave /3	-	0.37	0.64	74%
Pagesa sociale për perfutues individual (të njëhershme) /4	2.65	0.96	0.52	-46%
Subvencione për entitete publike (trajtime për punësim) /5	0.94	0.19	0.64	245%
Pagesa - vendime gjyqësore	-	-	-	0%
1.4.2 Subvencionet	40.66	49.63	42.85	-14%
Subvencionet për Ndërmarrjet Publike	8.83	7.59	8.76	15%
Subvencionet për RTK	4.42	4.88	4.80	-2%
Subvencionet për Bujqësi	8.95	20.39	6.34	-69%
Tjera /6	18.45	16.77	22.96	37%
2. Shpenzimet kapitale	136.66	115.60	134.24	16%
Ndërtimi i rrugëve	73.32	60.27	85.55	42%
Toka, shpronësimi	10.92	19.60	15.10	-23%
Ndërtesat (shkollat, spitalet, obj. tjera publike)	23.65	14.11	14.79	5%
Paisje (me vlerë më të lartë se Eur. 1000)	5.61	5.22	5.12	-2%
Automjete për transport dhe siguri publike /7	0.56	2.75	1.46	-47%
Transferet kapitale për entitete publike dhe jo-publike	1.67	1.91	3.15	65%
Investimet tjera kapitale /8	17.48	7.23	4.62	-36%
Pagesa për vendime gjyqësore	3.44	4.50	4.44	-1%
3. Gjithsej shpenzimet buxhetore (1+2)	624.54	659.92	706.26	7%

/1 Për qëllime të raportimit, pensionet e kontribut dhënësve janë ndarë si kategori e veçantë nga viti 2015. Prandaj, rënia në këtë kategori reflekton veçim ndryshime kontabël nga vitet paraprake, kur kjo pagesë ka përfshirë edhe kategorinë e pensioneve bazë kontribut dhënësve.

/2 Në vitin 2015 Ndihmat sociale janë me të vogla pasi që janë identifikuar në bazën e të dhënave të MPMS se disa nga këta perfutues të kësaj kategorie përfitojnë mjete nga burimet tjera.

/3 Për qëllime të raportimit, pushimet e lehonave janë ndarë si kategori e veçantë nga viti 2015. Në vitet paraprake kjo pagesë është bërë nga pagesa për perfutues individual.

/4 Pagesat nga perfutuesit individual në vitin 2015 ishin me të vogla si rezultat i pagesës për fëmijët me aftësi të kufizuara tek kodi pensionet për persona me nevoja të veçanta.

/5 Subvencione për entitete publike ishin me të vogla si rezultat i ndryshimit të rregullores së re për dhënien e subvencioneve.

/6 Përfshihen subvencionet për sport dhe kulturë, trajtimi jashtë vendit i pacienteve, pagesat për partitë politike, pagesat për perfutuesit individual, pagesat për provizionet e transfereve sociale, vendimet gjyqësore etj.

/7 Kryesisht përfshijnë shpenzimet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Niveli Komunal (Prishtinë, Glogoc, Prizren, Klinë, dhe Hani i Elezit).

/8 Kjo linjë përfshin investimet në: makineri, pasuri të paprekshme, pasuri biologjike, gjenerimin dhe transmisionin e rrymës, investimet vijuese nga vitet paraprake, dhe në shërbimet mbështetëse për realizimin e investimeve.

Aneksi 3: Buxheti dhe pagesat sipas organizatave buxhetore

Niveli Qendror

Përshkrimi	Ligji i Buxhetit Nr 05/L-071	Buxheti në SIMFK	Pagesat	Zotimet / Obligimet	Progresi ndaj BV,%
1	2	3	4	5	6=4/3
Rroga dhe paga	299,799,166	301,408,395	148,990,653	-	49%
Mallra dhe shërbime	145,723,218	148,039,020	58,918,349	18,328,992	40%
Shpenzime komunale	15,469,258	15,496,282	7,928,676	77,679	51%
Subvencione dhe transfere	444,370,000	444,761,791	207,821,041	448,208	47%
Shpenzime kapitale	346,137,225	343,954,676	102,463,327	75,948,122	30%
Rezerva	5,000,000	2,624,211	-	-	0%
Gjithsej	1,256,498,867	1,256,284,374	526,122,046	94,803,001	42%

Vërejtje: Në totalin e pagesave nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara te donatorëve dhe fondet mirëbesim.

Niveli Lokal

Përshkrimi	Ligji i Buxhetit Nr 05/L-071	Buxheti në SIMFK	Pagesat	Zotimet / Obligimet	Progresi ndaj BV,%
1	2	3	4	5	6=4/3
Rroga dhe paga	248,432,392	248,583,886	123,430,898	-	50%
Mallra dhe shërbime	38,222,300	39,686,120	16,198,168	2,567,086	41%
Shpenzime komunale	9,797,595	10,032,571	4,651,890	52,413	46%
Subvencione dhe transfere	8,667,743	9,515,515	4,081,516	471,435	43%
Shpenzime kapitale	117,090,589	133,060,115	31,773,965	24,020,918	24%
Gjithsej	422,210,619	440,878,206	180,136,438	27,111,852	41%

Vërejtje: Në totalin e pagesave nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara te donatorëve dhe fondet mirëbesim.